



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KATERTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoj, z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **21.04.2021 (e Merkur)**, në zyrën e konferencave në objektin e ri të komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen,

Kryesuesi z.Naim Pira: Më lejoni të ju përshëndes. Diçka në mes takimeve të komitetit, diçka të veçantë nuk kemi, vetëm se po vazhdon trendi i të infektuarave me Covid 19. Ne ju shprehim ngushëllime familjeve që kanë humbur më të dashurit e tyre si dhe të sëmurëve shërim të shpejtë. Zyra Ligjore na i ka kthyer disa vendime që i kemi miratuar në seancën e fundit të Kuvendit Komunal të Vitisë. Një vendim na i kanë rikthyer atë për Rregulloren për fshatra, për shkak se në bazë të një marrëveshje ndërsa të tjerat vendime që i kemi nxjerr na i kanë konfirmuar që janë në rregull . Diçka të veçante nuk kemi tjetër për me ju informuar. Për këtë seancë kemi paraparë këtë

R e n d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2021.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2020 në vitin 2021.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të integritetit për Komunën e Vitisë 2021-2023.**
- 5. Propozim për formimin e komisionit për procedurat e mëtutjeshme për dhënien me qira të vendgjuetisë në territorin e Komunës së Vitisë.**
- 6. Informatë për Manifestimin e Tradicional Kulturor-Sportiv “Flakadani i Karadakut 2021”.**
- 7. Informatë mbi përgatitjen e të mbjellave pranverore.**

A ka dikush rreth rendi të ditës?

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Meqenëse brenda kësaj periudhe kemi pasur dy njoftime nga ana e MAPL-së. Një e kemi pas që nuk kanë mund me na i konfirmuar për shkak të reduktimit të stafit që nuk kanë mund me u merr me vendime tonat për shpalljen e ligjshmërisë, është një propozim i drejtoreshës.

- 8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike).**

Është e mundur të hy në rend të ditës. Konstatohet se me vota unanime u miratua rendi i ditës më këtë pikë shtesë.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

A ka dikush rrethe pikës së parë të rendit të ditës? Pasi që nuk ka e qesim në votim për miratim. Konstatohet se me vota unanime u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2021

Ja kaloj fjalën drejtorit rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Ibrahim Rama: Kjo puna e pasqyrave financiare, është një rutinë që e sjellim çdo tre muaj, ku pasqyrojmë pasqyrat financiare. Materialin e kemi marr me kohë, do të mundohem vetëm në pika të shkurtra ta pasqyroj para jush. Duke u bazuar në Ligjin mbi Financat Publike dhe Ligjin mbi Qeverisje Komunale, raportet në tabelat financiare paraqesin këtë trend të dukurive. Në shifra të gjitha i kemi të pasqyruara në formë të tabelave. Për ma shumë po ja la hapësirën debatit. A kemi ndonjë pyetje apo sugjerim? Jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rrethe kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të pranishmit. Pasi që i morëm këtë listën e shpenzimeve, kisha pasqejf me i ditë këto shërbimet kontraktuese tjera që është 26644 euro, kodi është 13 460. A kishim mund me pas një listë të emrave, kush janë këta persona?

z.Bekim Azizi: Në tremujorin e parë na zakonisht problemin që është një shumë e vogël edhe janë vlera zakonisht të vogla, që ndoshta nuk ka hapësirë shumë të diskutohet, megjithatë te investimet kapitale prapë është vlerë e vogël kur krahasohet prapë po mbesin sikur vitet tjera, mirëpo unë çka pash këtu shihet një diferencë të mirëmbajtja e auto rrugëve lokale. Vitin e kaluar ka qenë 16 mijë, ndërsa këtë vit është 42 mijë euro. Pse kjo diferencë kaq e madhe? Mirëmbajtja e ndërtesave, edhe kjo do me thanë krahasuar me vitin e kaluar shihet një rritje. Desha me ta bë një pyetje, po e shoh që ka filluar prej vitit të kaluar dhe tash tenderët që po jepen me afatgjatë: a është kjo një diçka që po lidhet me atë që është fundi i mandate?, dhe e dini se këtë vit kemi me lan mandatin dhe po i leni do far vegëza që të shfrytëzohen edhe 2-3 vite të tjera. Unë dyshoj, definitivisht po lidhem edhe me atë që e ke lidh kontratën para vitit të ri me rregullimin e rrugëve rurale 800 mijë euro për tri vite edhe duke parë kjo mirëmbajtja e ndërtesave që ishte mbi 500 mijë euro. Unë po them se është një dyshim që len hapësirë për me u dyshuar.

z.Ekrem Abazi: Edhe unë kisha pak për të diskutuar për pasqyrat financiare. E pash se të hyrat për tremujorin e parë janë ma të mëdha se në vitin 2020, kjo ma së shumti e ka rrit tatimi në pronë, janë ma të mëdha se në vitin 2020. Kjo ma së shumti e ka rrit tatimi në pronë. Mjetet e alukuara janar- mars, viti 2021 është 78.14%. Kur e shikon përqindjen mirë, duket për shkak të vitit të pandemisë. Te pagat dihet ma, shërbime dhe mallra janë shpenzuar 45.44%, komunalit e pash 39.75%, te investimet kapitale shpenzimet me u bërë me periudha kur e krahason me vitin e kaluar këtë vit janë shpenzuar 44%, që unë personalisht jam i kënaqur, po nuk jam i kënaqur ku janë investuar këto shpenzime kapitale, a për shpenzime në rregull jemi. Shërbimet komunale, ujë, rrymë dhe mbeturina, janë të barabarta me shërbimet kontraktuese të tjera. Këto shërbimet kontraktuese tjera, me të vërtetë po bahen bajat. Pajisje tjera, e pash kodi 13509 ka kushtuar 14862 euro, çka janë këto pajisje tjera. Te Zyra e Kryetarit, shërbime dhe mallra i ka harxhuar 20%, a buxheti i aprovuar është 136 mijë euro, janë harxhuar nga kjo shumë vetëm 20%. Shërbime publike, mbrojtje civile dhe emergjente, pajisje tjera 13 113 euro; mirëmbajtja e rrugëve lokale 42229 euro. Me të vërtetë mu duken shumë. Po shkojmë te bujqësia, subvencione, asnjë nuk është ndarë hiq, alukimi i buxhetit 14 euro. Kjo të tregon ku jemi. Te shëndetësia, shërbime dhe mallra 54%, por po më intereson shpenzimet komunale 95 mijë euro janë shpenzuar vetëm 3089 euro, furnizim me lëndë djegëse dru, 4950 euro. A kanë me ditë sa metra janë porositur, edhe sa ka kushtuar një metër dru. Të hyrat tatimi në pronë, 439 mijë e 589 euro. A është totali për vitin 2021? Kur e shikon me përqindje është punuar mirë, janë inkasua 117 mijë euro. Te lejet e ndërtimit, 54 mijë euro janë për një vit, 3500 euro janë

paraparë, janë realizuar vetëm 2203 euro. Unë vetëm dy ndërtesa që kanë filluar që po i sheh me shirita e me sene, u dashtë 15/20 mijë, e jo kjo shumë qesharake. E pash te dënimet e trafikut, ish mirë 44 mijë euro, ndërsa të hyrat tjera 44882 euro. A kanë me ditë qa është kjo?, por kur e sheh në përgjithësi, duke

krahasuar me vitin e kaluar është ma mirë. Te investimet kapitale, asfaltimi i rrugëve rurale ish 78850 euro. Kur e shikova sa fshatra janë, 13, kur i pjesëtova me shumën, i bien që asfaltime në rrugë kemi për çdo fshat 6065 euro. A befasinë e kisha te rrugët me zhavorr, janë shtruar në 4 fshatra rrugët me zhavorr 201390 euro. Me pas qenë e kundërta, beso jam kanë i kënaqur. Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik 50 mijë euro. Kur i shikova fshatrat, shuma nuk është e madhe, krahasimi i shpenzimeve. Për fillim kaq kisha.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit anëtarë të KPF-së. Fjala për ty drejtor, urdhëro!

z.Ibrahim Rama: Po filloj nga fundi. Prej pyetjeve që u parashtruan nga Ekremi, edhe se mu përgjigje ne krejt, është begi kohë e gjatë, por do te mundohem në pika të shkurtra ta sqaroj. Po filloj nga të hyrat tjera, po filloj nga trafiku, mblidhen të gjitha të hyrat tjera nga gjykata, nga trafiku, nga gjobat e pyjeve. Krejt kur mblidhen e japin at shumë. Pyetje tjetër ishte pagesa për investime kapitale. Këtë vit nuk kemi punuar se ka qenë janari, shkurti, marsi, por janë faktuara të vitit 2020, që janë të paraqitura në raportin e pasqyrave financiare. Kontrata lidhet dyvjeçare, trevjeçare, me ligj ju ka mundësu kryetarit. Tash për shembull kompania ka punuar ma shumë dhe ka drejtë se e ka kontratën dyvjeçare. Kjo ishte një pyetje nga Bekimi, për shkak fushatës që po i lidhni 3 vjeçare, kontratat kjo nuk qëndron, se na edhe viteve te kaluara kemi bërë kësi kontrata. Ne kemi mbledh një vlerë prej mbi 400 mijë euro te tatimi ne pronë. Ne kemi pas të planifikuara 300 mijë euro, ndërsa na llogaritëm që 100 mijë euro kemi grumbulluar borxhe. Një pyetje tjetër ishte pajisje tjera, kodi ishte 13 509 furnizimi me të gjitha programet pjesa që e përmban 99% të këtij shpenzimi është dekorimi i qytetit për festat e fundvitit, 13 mijë euro. Pjesë tjetër ishte subvencionet në bujqësi. Këta e kanë dinamiken, e kanë fondin e rritur për subvencione, por për tremujorin e parë nuk kanë pasur mundësi me i kryer. Një pyetje tjetër për mallra dhe shërbime, për komunalit të vogla. Unë në fillim e thash se, kemi pas shumë probleme për personin zotues dhe na kanë mbetur edhe komunalit. Shumë faktuar na kanë mbetur pa paguar, për arsye se personi që i ka kryer ka vdekur prej Covidi dhe nuk kemi mund me zëvendësuar ende, se nuk kemi pasur mundësi me shpall konkurs. Kontratat shumë vjeçare u munduam me shpjeguar Bekimi për investime kapitale, kur e bami dinamiken e pares nga niveli qendror na kemi qejf me ju thanë qitna buxhetin krejt në janar, por ashtu edhe shteti nuk ka ku ti merr krejt paret. Kështu, se na e bëjmë një plan dinamik qe e ndajmë me faza.

z.Bekim Azizi: Kjo askund nuk asht e vërtet, se ne kemi pasur shpesh debat, se raportin je duke e bë keq, se unë asnjëherë nuk i kam shikuar mjetet e alukuara, por i kam shikuar me atë të planifikuara. Tash realizimi matet me buxhet të planifikuar.

z.Ibrahim Rama: Buxheti është i miratuar 12 milion, kështu po thua ti, na këtë buxhet e marrim e shikojmë me drejtorë qysh me na ardhur mjetet tash. P.sh.: drejtori i shërbimeve publike i dua 100 mijë euro, ai i planifikon punët e veta qysh ka me i ndarë.

z.Jakup Demiri: Unë dua me i thanë drejtorit, se nuk është ashtu në nivel qeverie, e pranon kështu se nuk dërgohet asnjë fitbek për me shikua të këtij buxheti, a është i planifikuar mirë për me u implementuar mirë. Unë po mendoj se Bekimi e ka mirë, se kurrë nuk mundet me të dal 100%. Te puna e faktuarave, po të tregoj, se ti ke paguar fatura edhe pa u përfunduar puna. Ke raste te tatimi ne pronë, që shumë punëtorë kanë obligime mbi 700 euro edhe nuk e paguajnë tatimin.

z.Ibrahim Rama: Këtu nuk pajtohem hiq edhe ti si ekonomist nuk duhet me thanë ashtu, e gjenë ndonjë fakturë që e kam paguar pa përfunduar punimet, unë shkoj me duar të lidhura. Te faktuarat që nuk janë kryer punët dhe janë paguar, jo me ditë, por edhe mos me ditë unë që ka ndodhur, unë shkoj në përgjegjësi.

z.Bekim Azizi: Unë po të them që nuk është qashtu drejtor, se e ke rregullimin e lumit “Morava”, i ke 530 mijë metra kub dhe i ke hekë. Unë po të themë se me qeto metra një lum të ri e hap, po thuaj mua me sjellin të nënshkruar ingjinierat, se si ta shoh të nënshkruar unë nuk kam asnjë përgjegjësi. Ti e cek edhe shumë herë momentin që ma sjellin faturën e nënshkruar, unë e bej pagesën saktë kështu ke thënë.

z.Ibrahim Rama: Ti e dinë një faturë që e kemi paguar pa i kryer punët, unë shkoj në përgjegjësi.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Mos këmbëngulni në atë drejtim, për shkak se ne i kemi dy auditime. Aty që po e cek ti, mundet me pas ndërrim të pozicioneve. E dyta që the, nuk bahet realizimi në baza të planifikimit, dëgjo te taksat komunale të cilat i kanë klasifikuar krejt taksa komunale, përpara nuk kanë

qenë taks administrative. U thirr për shërbimin aty për aty dhe taksë komunale për hapësirë që e paguajnë. Aty mund me nxjerr pagën reale.

Kryesuesi z.Naim Pira: Atëherë unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë për këtë pikë të rendit të ditës.

Po kalojmë në pikën tjetër

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2020 ne vitin 2021

Përsëri fjala për ty drejtor!

z.Ibrahim Rama: Të nderuar anëtar të komitetit, në fund të vitit 2020 kanë qenë mjete të pa shfrytëzuara, që janë grumbulluar në fund të vitit 189821 euro. Këto mjete janë të alukuara në kodet që kanë qenë, sepse nuk mund ti ndërrojmë. Kaq për fillim, për ma shumë a ka dikush ndonjë pyetje apo ndonjë sugjerim? Jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit drejtor, hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

z.Bekim Azizi: Nuk kam diçka qe me shtua, se e di kjo formë qysh shkon vetëm te kjo faqe e fundit, bartja nga viti 2019. A ka mbet prej shablloni që nuk e keni përmirësuar apo?

z.Ekrem Abazi: Desha ta shprehi, p.sh.: te administrata janë 6983 euro, inspeksioni 4000 euro, Zyra e Kuvendit Komunal 6000 euro, a ka arsye zyrës së kuvendit me ju nda 6000 euro, infrastrukturë publike 5000 euro. Unë kisha propozuar te administrata 2000 euro, te inspeksioni 1000 euro, te zyra e kuvendit 2000 euro edhe te infrastruktura 5000 euro te kalojnë në shëndetësi dhe mirëqene sociale. Te subvencionet, te zyra e kryetarit 26340 euro. Kryetari i ka 102 mijë euro subvencione. Kisha propozuar së paku 6 mijë euro me kaluar te bujqësia. Kaq, nuk kam ma shumë me shtuar.

znj.Xhylsime Qamili: Unë pajtoj se shërbimet edhe mallrat qysh e propozoj Ekremi, e lejon ligji që të barten. Na e dimë se shëndetësia nuk ka qenë mangur, por duke pas parasysht se ka qenë Virusi Covid 19.

z.Ibrahim Rama: Të nderuar, edhe një herë po e cekim, asnjë ndryshim nuk guxojmë më bë, se këto mjete barten në kodet qe kanë qenë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka tjetër për diskutim, e hedhim ne votim që te shkoj për miratim për kuvend. Kush është që të shkoj kjo pikë. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pik tjetër të rendit të ditës do të kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të integritetit për komunën e Vitisë 2021-2023

Fjala për ty nënkryetar!

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Materialin e keni marr me kohë, kjo është për shkak të performancës. Ma herët e keni pas një plan, tash i ka ardhur koha që të rifreskohet, kaq.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutem? Nuk ka, me këto vërejtje që u ceken e qes ne votim që të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër të rendit te ditës kemi:

5. Propozim për formimin e komisionit për procedurat e mëtutjeshme për dhënien me qira të vendgjuetisë, vendin e gjuetisë në territorin e Komunës së Vitisë

A nuk ka kush për të diskutuar? Kush është që ti rekomandohet kuvendit edhe kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me vota unanimit shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

6. Informatë për Manifestimin e Tradicional Kulturor-Sportiv Flakadani i Karadakut-2021

Ja kaloj fjalën zyrtarit të DKRS-së, të na i paraqet në pika të shkurtra.

z.Ismet Sejdiu: Përshëndetje për të pranishmit. Në mungesë të drejtorit, sot kam ardhur unë ta paraqes informatën për manifestimin tradicional kulturor-sportiv "Flakadani i Karadakut" për vitin 2021. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje apo ndonjë shpjegim jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

z.Jakup Demiri: Te shpenzimet dreka dhe shpenzime 3270 euro, po e llogarisim pjetën ka 3.20 euro ti 1 mijë personave nuk ju keni dhanë dreka. Shtypje, materiale, grafike, banera, flamuj, beze, 3305 euro. Transmetimi i drejtpërdrejt në televizion, 2347 euro, po më duket se kjo është gjynah, a janë mërddhi njerëzit nxemje nuk ka pasur.

z.Bekim Azizi: Vetëm te drekat desha mu lidh, se mu duken shumë mundësisht për kuvend me na sjell edhe faturat.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Pasi kjo pikë nuk votohet, si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

7. Informatë mbi përgatitjen e të mbjellave pranverore

A ka dikush rreth rendit të ditës? Ja kaloj fjalën drejtoreshës rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Arlinda Sahiti: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ka sjellë këtë informatë rreth të mbjellave pranverore. Materialin e keni marr me kohë, nëse ka dikush një pyetje, jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

z.Bekim Azizi: Unë shumë shkurt te planifikimi. Si e bani, apo veç e shkruani sa ju merr mendja, apo konsultoheni me njerëz sa ka me mbjell. Me na tregu si e bëni këtë planifikim.

z.Arlinda Sahiti: Për këtë plan është përgjegjës zyrtarja Fadile Demelezi, për të mbjellat pranverore i kemi shikuar statistikat, kështu është.

z.Ekrem Abazi: Te informata, mirëpo këto janë vetëm supozime të vërteta nuk ka asgjë. Po unë nuk pash që kemi bërë diçka për qytetarët, për mbjelljet pranverore.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka tjerë për diskutim, e falënderoj drejtoreshën që ka sjellë këtë pikë.

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike)

Ja kaloj fjalën drejtoreshës rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Majlinda Ostrogllava: Ne kemi pasur edhe ma herët këtë pikë, por e kemi kthyer për shkak të mos ndarjes së pronave. Tash e kemi sjell prapë në kuvend, është i njëjti propozim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Bekim Azizi: Në bazë të kësaj që na ka ardhur lista plotësuese, nuk është tjera hapësira nuk ka, është vetëm rruga kryesore.

Kryesuesi z.Naim Pira: E hedhim në votim që të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira